



Kuvendi Komunal
Datë: 16.09.2024

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETËVE
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETËVE
SHËRBIM ZATËR ZËR ZA USLUGU GRADANA

Sh. U. Nr. 01 Br. 29488

Nr. i faq. 1 Data: 16/09
Br. str. Datum: 2024
KAMENICE/A

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Mbështetur në nenin 52 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 11 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.05/2020 Për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve të Tjera në Komunë, për mbajtjen e mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi i Kuvendit me datë: 16.09.2024 :

T H Ë R R E T

Mbledhjen e -IX-të të Komitetit për Politikë dhe Financa e cila do të mbahet ditën e **Hënë** me datë: **23.09.2024**, duke filluar nga ora **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës.

Për mbledhje propozoj këtë,

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit, nga mbledhja e VIII-të e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Propozim-vendim për shqyrtimin dhe aprovimin e draft-buxhetit komunal për vitin 2025-2027.
3. Të ndryshme.

Liridon KASTRATI
Kryesues i Kuvendit të Kamenicës



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

REPUBLICA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PER SHËRBIM TE QYTETIT
CENTAR ZA USLUGU GRADANA

Sh. 01 Nr. 29491
U. 01 Br. 29491

Nr. i faq. 2 Data: 16/08
Br. str. 2024 Datum: 2024

KAMENICËJA

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e VIII-të e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më: 19.08.2024

Mbledhja u mbajt në objektin e komunës dhe filloj ora 10:05. Në mbledhje përveç anëtarëve të pranishëm ishin edhe shërbimi profesional i kuvendit, përkthyesi, përfaqësues të zyrës për Informim dhe përfaqësues të OSBE-së. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa Liridon Kastrati i cili për mbledhje propozoi këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e VII-të e Komitetit për Politikë dhe Financa,
2. Kërkesë nr.05-6032 nga MAPL-ja për shqyrtimin dhe harmonizimin e Vendimit nr.21033,
3. Të ndryshme

Liridon Kastrati-Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kamenicës, po fillojmë me mbledhjen e tetë të Komitetit për Politikë dhe Financa, a keni propozime shtesë për rend dite, nëse nuk keni unë i propozoj

1. Rishqyrtimi i vendimit Nr. 21061
2. Rishqyrtim i vendimit Nr. 21059

Kush është për miratimin e rendit të ditës?
Për të gjithë

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e VII-të e Komitetit për Politikë dhe Financa,

Liridon Kastrati-Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kamenicës, jemi tek pika e parë e rendit të ditës, a keni vërejtje rreth procesverbalit, nëse nuk keni e hedhim në votim, Kush është për miratimin e procesverbalit,
Për u deklaruan të gjithë.

2. Kërkesë nr.05-6032 nga MAPL-ja për shqyrtimin dhe harmonizimin e Vendimit nr.21033,

Liridon Kastrati-Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kamenicës, kemi të bëjmë me mbylljen e AMF-së të serbëve dhe nga MAPL kërkohet që të harmonizohet sipas rekomandimeve të tyre. Është kërkuar që të bëhet harmonizim këtyre të bëhet propozim ministrisë së shëndetësisë pasi që kompetencë për këtë është kjo ministri dhe në bazë të këtij rekomandimi propozojmë që të shfuqizohet kjo pikë dhe të ecim tutje. A e dëshiron dikush fjalën?

Magbule Kastrati- ku e ka paraparë kryetari vendosjen e këtij stafi të kësaj AMF-je?

Liridon Kastrati-Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kamenicës- këtë pyetje do ta adresojmë tek kompetentët. Nëse nuk keni diskutime tjera e hedhim në votim,

Kush është që kjo pikë të shfuqizohet?

Për u deklaruan të gjithë.

3. Të ndryshme

Florim Kryeziu-Kërkohe raport për arsyeshmërin e propozimit të pronës për znj. Qëndresa Gagica? Në mbledhje të jenë prezent përfaqësuesit e Komisionit, përfaqësues të inspektoratit të komunës, drejtorja e pronës dhe drejtorja e Zhvillimit Ekonomik dhe Diasporë ?

Liridon Kastrati-Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kamenicës-nga shërbimi i kuvendit do të adresohen këto pyetje aty ku ju kërkuat. A keni diskutime të tjera, nëse nuk keni e shpallim të mbyllur takimin e sotëm.

Takimi mbyllet ora: 10:20

Procesmbajtës


Sabile Arifi

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kamenicës





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

REPUBLICA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTYMARE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Sh. U. 01 Nr. Br. 29491

Nr. i faq. Sr. str. 2 Data: 16/09 2024
KAMENICË/A

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



ZAPISNIK

Sa VIII-e sednice Komiteta za Politiku i Finansije održano dana: 19.08.2024

Sednica održana u objekat opštine i počela u 10:05. Na sednici osim članova prisutni bili i stručna skupštinska služba, prevodilac, predstavnik kancelarije informisanja i predstavnik OEBS-a. Sednicu otvorio i njome predsedavao Predsedavajući Komiteta za Politiku i Finansije Liridon Kastrati koji za sednicu predložio sledeći ovaj:

Dnevni red

1. Razmatranje i usvajanje zapisnika sa VII-e sednice Komiteta za Politiku i Finansije,
2. Zahtev MALS-a br.05-6032 za razmatranje i usklađivanje Odluke br.21033,
3. Razno.

Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica, počinjemo sa osmom sednicom Komiteta za Politiku i Finansije, ako imate predloge za dopunu dnevnog reda, ako nemate ja predlažem:

1. Razmatranje odluke Br. 21061
2. Razmatranje odluke Br. 21059

Ko je za usvajanje dnevnog reda?
Za su svi

1. Razmatranje i usvajanje zapisnika sa VII-e sednice Komiteta za Politiku i Finansije

Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica, nalazimo se kod prve tačke dnevnog reda, imate li primedbe na zapisnik, ako nema, stavljam na glasanje,
Ko je za usvajanje zapisnika,
Za su se svi izjasnili.

2. Zahtev MALS-a br.05-6032 za razmatranje i usklađivanje Odluke br.21033,

Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica, radi se o zatvaranju APM-e, srba Centar i od MALS-a se traži usklađenje po njima. Traženo da se vrši usklađenje, da se ministarstvu dostavi predlog tj. ministarstvu zdravstva, budući da nadležni za ovo je ovo ministarstvo i po ovoj preporuci predlažemo da se ova tačka stavi van snage i idemo dalje. Želi li se neko javiti za reć?

Magbule Kastrati- gde je predvideo predsednik da ovo osoblje ove APM-e smesti?

Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica – ovo pitanje postavicećemo nadležnima. Ako nemate diskusije stavljam na glasanje,

Ko je da se ova tačka stavi van snage?

Za se svi izjasnili.

3. Razno


Florim Kryeziu-Traži se izveštaj za obrazloženje predloga za g-đu Qëndresa Gagica? Na sednici da budu prisutni članovi Komisije, predstavnici opštinske inspekcije, iz odeljenja za Imovinu, i odeljenja za Ekonomski Razvoji Dijasporu?

Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica-od skupštinske službe će se tražiti ova pitanje koje ste vi tražili. Ima li diskusije, ako nema današnju sednicu proglašavam zatvorenom.

Sednica zatvorena u: 10:20

Prevod: Rexhep Ibrahim

Zapisničar


Sabile Arifi

Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica


Liridon Kastrati



REPUBLICA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
 QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETI PËR
 CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Sh. 05 Nr. 27962
 U. _____ Br. _____

Nr. i faq. 20 Data: 30/08
 Br. str. _____ Datum: 2024
 KAMENICË/A



Republika e Kosovës
 Republika Kosova
 Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
 Opstina Kamenica
 Kamenica Municipality



DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

REFERENC-Ë:					
PËR/ZA/TO: Kryetarin e Komunës - z. Kadri Rahimaj Kryesuesin e Kuvendit Komunal-z .Liridon Kastrati					
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:					
NGA/OD/FROM: Drejtore e DFB-së - znj. Ardita Dermaku					
TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT: Propozim Buxheti 2025-2027					
Nr. i Zyrës:		Lokacioni:		Data:	
Br. Kancelarije:		Lokacija:		Datum:	30.08.2024
Room No:		Extencion:		Date:	
Për aktivitet/Za aktivnost/For action/					
Për miratim/Za ushvanje/For aprova/					
Për nënshkrim/Za potpis/ For signature/					
Për komente/Za komentare/For comments/					
A mund të diskutojmë/Dali možemo raspravljati/ May we discuss/					
Vëmendja e juaj/ Vaša pažnja/Your attention/					
Sipas diskutimit/Kako je raspravljeno/As discussed/					
Siç është kërkuar/ Kako je zatraženo/As requested/					
Shënim dhe përgjigje/ Beleška i odgovor/ Note and retur/					
Për informimin tuaj/ Za vašu informaciju/ For your information/					
Afati/ Rok/Deadline/					

Të nderuar :

Duke u bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë neni 61 Shqyrtimi i Buxhetit Komunal nga Kuvendi Komunal paragrafi 61.2 Pas pranimit të propozim-buxhetit,Kuvendi Komunal do të mbajë dëgjime publike në përputhje me aktet e aplikueshme ligjore të komunës.Pas këtyre dëgjimeve,Kuvendi Komunal,deri më datën e përcaktuar në paragrafin 3 të nenin 20 të këtij ligji,duhet ta shqyrtojë,ndryshoj siç e shih të nevojshme ose të arsyeshme si dhe të miratojë dhe t-ia dorëzoj Ministrin propozim-buxhetin komunal.

Me respekt



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



KAMENICË

PROPOZIM-BUXHETI KOMUNAL 2025-2027



5.22%

Kamenicë, 30.08.2024

HYRJE

Dokumenti paraqet një profil të shkurtër të komunës, përmban një pasqyrë të përgjithshme të buxhetit komunal ,zhvillimit të procesit buxhetor ,strukturës së financimit ,synimet e qeverisë lokale ,kufijt e financimit ,konkluzionet përmbyllëse dhe caktimi i prioriteteve tabela e shpërndarjes të buxhetit sipas drejtorive dhe kategorive të shpenzimeve dhe trendet në tre vitet e fundit, si dhe listën e projekteve të investimeve kapitale të planifikuara nga komuna për vitin 2025-2027.

PROFILI I KOMUNES – KAMENICA

Komuna: KAMENICA

Popullsia: 36.085 banorë

Sipërfaqja: 414 km²

Struktura e Kuvendit Komunal:

Kryetari i Komunës: z. Kadri Rahimaj

Kuvendi Komunal: 27 anëtarë

Drejtoritë komunale:

Administratës së Përgjithshme

Arsimit

Ekonomisë, Financave dhe Buxhetit

Urbanizmit dhe Planifikimit Hapsinor

Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi

Shëndetësisë dhe M. sociale

Shërbimeve Publike

Investime Kapitale

Kulturë, Rini dhe Sport

Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural

Inspektoriati

PASQYRA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT KOMUNAL

Shqyrtimet Hyrëse:

BAZUAR NË LIGJIN NR. 03/L-048 PËR MENAXHIMIN E FINANCAVE PUBLIKE DHE PËRGJEGJËSITË

- **Neni 61**

61.1 Pas miratimit të propozim –Buxhetit komunal nga Kryetari i Komunës, Kryetari i Komunës,deri me 1 shtator të vitit përkatës fiskal,duhet t`ia dorëzojë këto dokumente Kuvendit Komunal.

61.2 Pas pranimit të propozim-buxhetit, Kuvendi Komunal do të mbajë dëgjime publike në përputhje me aktet e aplikueshme ligjore të komunës.Pas këtyre dëgjimeve, Kuvendi Komunal, deri në datën e përcaktuar në paragrafin 3 të nenit 20 të këtij ligji, duhet të shqyrtojë, ndryshojë siq e sheh të nevojshme ose të arsyshme si dhe të miratojë dhe t`ia dorëzojë Ministrin propozim-buxhetin Komunal.

61.3 Buxheti i miratuar Komunal duhet të jetë në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji dhe udhëzimet e dhëna në qarkoret buxhetore të nxjerra nga Ministri.

Aktivitetet dhe Zhvillimet Buxhetore

Procesi i planifikimit të buxhetit, është zhvilluar në përputhje të plotë me kalendarin kohor të përcaktuar nga MF-ja sipas :

- Qarkores Buxhetore 2025/01 të pranuar më 15.05.2024
- Qarkores Interne Buxhetore 1- të dërguar Drejtorëve me 15.05.2024
- Qarkores së dytë 2025/02 të pranuar më datë 14.08.2024
- Qarkores së dytë interne 2-të dërguar Drejtorëve 19.08.2024
- Dëgjime Buxhetore /Orari I takimeve me qytetar dhe grupe të interesit 25 dëgjime/

Komuna e Kamenicës në bashkëpunim me të gjitha drejtoritë komunale ka planifikuar buxhetin për vitin 2025-2027 duke u bazuar në Buxhetimin e përgjegjshëm gjinor në aktivitetet e tyre dhe prioriteteve .

Më 24.06.2024, Kuvendi Komunal-Kamenicë ka miratuar Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025-2027, si pjesë përbërëse e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) të Kosovës, e hartuar në përputhje me procedurat e parashikuara buxhetore 2025-2027, të dhëna nga MF përmes Qarkores Buxhetore 2025/01 dhe Qarkores Buxhetore 2025/02. Korniza Afatmesme Buxhetore si dokument strategjik prezenton parashikimet dhe supozimet ekonomike dhe buxhetore, strategjinë zhvillimore komunale, totalët e vlerësuara të të hyrave nga të gjitha burimet e financimit, caqet totale te shpenzimeve sipas kategorive ekonomike . Korniza Afatmesme buxhetore 2025-2027është dorëzuar në MF më datë **27.06.2024**.

Komuna e Kamenicës, për vitin 2025 ka një rritje të buxhetit duke krahasuar me vitin 2024 (**758,807.00€**) apo shprehur në % **5.22%**, ky realitet mundëson të konstatojmë se kjo rritje buxhetore ka rrjedhë si pasojë e rritjes së Grandeve Qeveritare dhe të hyrave komunale.

ZHVILLIMI I PROCESIT BUXHETOR KOMUNAL PËR VITIN 2025-2027

Me qëllim të përmbushjes së afatit ligjor për përgatitjen e projekt buxhetit 2025 është thelbësore që Komuna e jonë ka vepruar në pajtim me kalendarin buxhetor të përcaktuar në LMFP në përputhje me Qarkoren Buxhetore 2025/01 dhe 2025/02.

Organizata jonë buxhetore (653) ka zhvilluar procesin e hartimit të draft-buxhetit për vitet 2025-2027, në harmoni të plot me instruksionet e pranuar nga Ministria e Financave përmes qarkoreve buxhetore, si dhe në zbatim të ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, me qëllim që finalizimi të jetë në përputhje me interesat e përgjithshme të qytetarëve të komunës sonë në përputhje me kufijt e limituar të financimit. Projekt-buxheti sipas burimeve të financimit, përmban edhe projeksionet e shpenzimeve dhe prioritetet e qeverisë lokale të shpërndara në pesë kategori buxhetore dhe nënkategori të shpenzimeve.

Ministria e Financave ka hartuar qarkoret buxhetore bazuar në të dhënat e përcaktuara nga Komisioni i Granteve i cili ka mandatin e përcaktimit të vlerës së granteve duke zbatuar kriteret e përcaktuara si numri i popullsisë, madhësia gjeografike numri i nxënësve, stafi i mësimënsve, stafi profesional dhe ndihmës, numri i pakicave kombëtare. Nga këto përcaktime të Komisionit të Granteve ka rezultuar se buxheti i organizatës sonë buxhetore për vitin 2025 do të jetë në shumën prej **15,252,624.00€**.

STRUKTURA E FINANCIMIT BUXHETOR

Struktura e financimit buxhetor të komunës përbëhet prej dy burimeve të financimit dhe atë:

1. GRANDI QEVERTAR 2025 :

- Granti i përgjithshëm,
- Granti specifik i arsimit;
- Granti specifik i shëndetësis dhe
- Shërbimet Sociale Rezidenciale


2.TË HYRAT VETJAKE KOMUNALE 2025

Struktura e Financimit


Pershkrimi	2,023	Pjesëmarrja në %
Grandi i pergjitheshem	6,452,896.00	42.22
Grani i Arsimit	5,433,969.00	35.56
Grandi i shendetesise	2,041,687.00	13.36
Shërbimet Sociale Rezidenciale	220,000.00	1.44
Të hyrat vetjake	1,134,072.00	7.42
TOTALI	15,282,624.00	100.00

Buxheti i vitit 2025 krahasuar me vitin 2024 karakterizohet me rritje të shumës buxhetore për grantin qeveritar/ Grandi i Shëndetësisë, Grandi I Shërbimeve Sociale Rezidenciale/ dhe të hyrave vetjake. Mbështetur në totalin e buxhetit për vitin 2025 rezulton se kemi rritje të vlerës buxhetore krahasuar me vitin 2024 për 5.22 %.


Paraqitja Grafike e Grandit të Përgjithëshëm për vitet 2023-2027




Paraqitja Grafike e Grandit të Arsimit për vitet 2023-2027




Paraqitja Grafike e Grandit të Shëndetësisë për vitet 2023-2027



Paraqitja Grafike e Grandit të Shërbimeve Sociale Rezidenciale për vitet 2023-2027



Paraqitja Grafike e të hyrave vetanake për vitete 2023-2027



Synimet e qeverisë lokale në kuadër të planifikimit buxhetor.

Në bazë të planifikimit të buxhetit për vitin 2025 dhe krahasuar me buxhetin 2024 Komuna e Kamenicës ka ndryshime në kategori të caktuara ekonomike.

Shpenzimet rrjedhëse: Programet /Drejtoritë/ kanë bërë kërkesat e tyre përbrenda kufizimeve buxhetore. Është thelbësore që të gjitha drejtoritë iu janë përmbajtur kufijve të dhënë në bazë të Qarkorës 2025/02. për vitet 2025-2027. Shpenzimet operative për vitin 2025 dhe vlerësimet për vitet 2026-2027 do të pësojnë ngritje të lehtë në krahasim me vitin 2024. Kjo rritje ka të bëjë kryesisht me rritje në kategori ,Paga dhe Mëditje ,Mallrave dhe Shërbimeve,shpenzime Komunale dhe Subvencione dhe investimeve Kapitale.

Punësimi: Në parim stafi I të punësuarëve është rritur për 14 që në totale nga 1140 në 1154.Është bërë rritja e stafit në Sektorin e Arsimit për hapjen e qerdheve të reja dhe funksionalizimin e qerdheve ekzistuese.

Kategoria per Paga dhe Meditje-

Në vitin 2025 kemi një rritje të kësaj kategorije krahasuar me vitin 2024 për **2.28%** shprehur në masë monetare prej (205,009.00), kategoria e shpenzimeve për paga dhe mëditje historikisht ka përfaqësuar pjesën më të madhe të shpenzimeve rrjedhëse dhe gjithashtu planifikohet që përgjatë periudhës planifikuese trendi i njëjtë të vazhdojë.Në kategorinë e shpenzimeve **Paga dhe mëditje** kalkulimi është bërë duke u bazuar pagat e muajit qershor nën supozimin e koeficientëve ekzistues ..Krahasuar me vitin 2024 rritja e kësaj kategorie për Paga dhe mëditje krahasuar me vitin 2024 ,për vitet 2025-2027 do te jete 13.80%, ndërsa vetëm për vitin 2025 do të jetë 2.28%

. Kriteret që janë marrë për bazë në këtë kategori janë:

- Gjendja e tanishme e punëtorëve aktual,
- Staf i rritur dhe harmonizimi I tyre sipas nënprogrameve prej 14 punëtorëve
- Punëtorët me pushim pa pagesë
- Punëtorët në pushim të lehonisë
- Numri I pozitive në procedure /konkurse/
- Kontrata kolektive

Kategoria per Mallra dhe sherbime-

2 Mallrat dhe Shërbimet: /Kategoria e mallrave dhe shërbimeve pritet të rritet prej 6.50% në krahasim me vitin 2024. Pjesëmarrja e kategorisë për mallra dhe shërbime në shpenzime të përgjithshme të buxhetit të komunës ,për vitin 2025 do te jete 60.10%,ndërsa krahasuar me vitin 2024 ka një rritje të lehtë prej 2.28.Kjo rritje është bazuar në rritje të cmimeve për furnizime dhe shërbime.

Kategoria për shpenzime Komunale –

3. Në bazë të kufijve të caktuar nga Qarkorja 2025/02 për vitin 2025-2027 del se komuna e Kamenicës ka bërë planifikimin e buxhetit me rritje për shkak të shpenzimeve të mëdha, sidomos kategoria për rryme ngase ka shpenzime në ndriçime publike sepse kemi shtrirje të rrjetit të ndriçimit publik në fshatra dhe qytete . Pjesëmarrja e kategorisë për shpenzime komunale në shpenzime të përgjithshme të buxhetit të komunës gjate vitit 2025 te jete 1.71% , ndërsa krahasuar me vitin 2024 ka rritje prej 3.15%

Kategoria per Subvencione

4.Në bazë të kufijve të caktuar nga Qarkorja 2025/02 për vitin 2025-2026 del se komuna e Kamenicës ka një planifikim të buxhetit të rritur krahasuar me vitin 2024.Kemi kërkesa për subvencionim për biznese të ndryshme dhe aktivitetet e planifikuara nga Grupi i grave dhe Drejtoria për ekonomi, kërkesa për subvencionim edhe në përkrahje të bujqve të komunës, subvencionimi në Drejtorinë për KRS për aktivitetet vjetore /manifestimet/ dhe përkrahje klubeve të ndryshme.Pjesëmarrja e kategorisë për subvencione në shpenzime të përgjithshme të buxhetit të komunës, gjate vitit 2025 do te jete 5.79%,ndërsa krahasuar me vitin 2024 ka rritje prej 36.57%.

Kategoria per Investime kapitale

Në bazë të kufijve të dalur nga Qarkorja 2025/02 për vitin 2025-2027 del se komuna e Kamenicës ka një planifikim të buxhetit më të lartë krahasuar me vitin 2024 ka një rritje prej 6.80 % apo (160,972.00) €.Kjo rritje ka rezultuar të jetë si rezultat i ndarjes dhe rritjes së Grandit të Përgjithëshëm.Pjesëmarrja e kategorisë për Investime kapitale në shpenzime të përgjithshme të buxhetit të komunës, gjatë këtij viti 2025 do të jetë 16.54% .

PËRMBLEDHJA E KATEGORIVE BUXHETORE

	2024	2025	Dallimi	
Paga dhe Meditja	8,980,426.00	9,185,435.00	205,009.00	102.28
Mallra dhe Shërbime	2,274,272.00	2,422,098.00	147,826.00	106.50
Shpenzime Komunale	254,000.00	262,000.00	8,000.00	103.15
Subvencione	648,000.00	885,000.00	237,000.00	136.57
Investime kapitale	2,367,119.00	2,528,091.00	160,972.00	106.80
TOTALI	14,523,817.00	15,282,624.00	758,807.00	105.22

Në kuadër të administratës së organizatës sonë buxhetore(653) janë paraparë me organogram të miratuar në Kuvend të komunës këto programe :

01-Zyra e Kryetarit

02-Zyra e Kuvendit

03-Drejtoria e Administratës së Përgjithshme

- Cështja Gjinore

04-Drejtoria e Financave dhe Buxhetit

05-Sherbimet Publike Ambientit dhe Inspektoratit

Në kuadër të Shërbimeve Publike janë paraparë nënprogramet:

- *Infrastruktura Publike*
- *Zjarrëfikësit dhe Inspekcioni*

06-ZLK

07-Bujqësia

08-Shërbimet Kadastrale

09-Urbanizmi dhe Planifikimi Hapsinor

-Drejtoria e Investimeve

10-Ekonomi,Zhvillim dhe Diasporë

11-Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

- *Administrata e Shëndetësisë*
- *Shërbimet e shëndetësisë primare*

Shërbimet Sociale dhe Rezidenciale

- *Shërbimet Sociale*
- *Shërbimet sociale rezidenciale*

12-DKRS

13-Arsimi

Kufijt e financimit

Qarkorja buxhetore 2025/02 ofron instruksioneve mbi ecurin e procesit të hartimit të buxhetit, përcakton qartë edhe limitet e financimit për të gjitha kategoritë. Kategoritë e shpenzimeve operative/ Paga dhe mëditja ,Mallra dhe Shërbime,Komunali,subvencione/ dhe Investimeve kapitale kanë një kufi të përbashkët.

Buxheti i vitit 2025 është i financuar nga dy burime: 1) **Granti qeveritar**, dhe
2) **Të hyrat vetjake**.

Financimi i Buxhetit nga granti qeveritar vazhdon të jetë burimi kryesor i përbërjes së buxhetit të komunës. Pothuajse çdo vit kemi shënuar ngritje të vlerës së grantit qeveritar përfshirë të katër grantet, për vitin 2025 kemi një ngritje të grandit qeveritar për 4.75%,.Granti qeveritar si burim parësor i bërjes së buxhetit për vitin fiskal 2025 ka pjesëmarrje prej **92.58%** në totalin e vlerës buxhetore.

Nr	Emërtimi i Grandit	Shuma e Grandit Qeveritar	Buxheti Total	Pjesemarrja %
1	Grandi Qeveritar	14,148,552.00	15,282,624.00	92.58
	TOTALI	14,148,552.00	15,282,624.00	92.58

Krahasuar me vitin 2025 totali i Grandeve në vitin 2025 është rritur për 4.75% nga se kemi rritje të Grandi i Përgjithëshëm prej 7.97%,Grandi I Shëndetësisë 7.86% , Shërbimet Sociale rezidenciale rritje për 11.52%

	Grandet Qeveritare 2024	Grandet Qeveritare 2025	Ndryshimi

TOTALI	13,507,196.00	14,148,552.00	641,356.00
	13,507,196.00	14,148,552.00	641,356.00

2.TË HYRAT VETJAKE

Burimi i dytë i financimit të buxhetit, të hyrat vetjake, marrin pjesë me **7.42%** të përbërjes së buxhetit për vitin 2025, dhe krahasuar me vitin 2024 kemi një **trend të rritjes** të vlerës së planifikuar për 11.55%.

	Te hyrat totale vetjake 2025	Totali I Buxhetit 2025	Pjesëmarrja
Te hyrat Vetjake	1,016,621.00	15,282,624.00	7.42%
TOTALI	1,016,621.00	15,282,624.00	7.42%

Përmes planit të të hyrave 2025 organizata buxhetore pasqyron totalin e planifikuar për vitin buxhetor duke patur për bazë vlerën vjetore si objektiv , si dhe duke e shpërndarë vlerën e parashikuar në të gjitha llojet e të hyrave.

TABELA E BUXHETIT NGA TE HYRAT VETANAKE 2024/2025

	Të hyrat vetjake 2024	Të hyrat vetjake 2025	Diferenca	Ndryshimi
Te Hyrat Vetjake	1,016,621.00	1,134,072.00	117,451.00	111.55
TOTALI	1,016,621.00	1,134,072.00	117,451.00	111.55

Gjithsesi duhet theksuar se bazë ligjore për grumbullimin dhe shpenzimin e të hyrave vetanake janë ligjet e miratuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës si: ligji mbi vetëqeverisjen lokale, ligji mbi financat lokale, rregullorja e komunës mbi tarifrat dhe ngarkesat komunale si dhe ligji mbi Tatimin në Pronë.

Tatimi në pronë

E hyra kryesore në kuadër të të hyrave vetanake është **Tatimi në Pronë 438,943.00+Tatimi në tokë 103,170.00 totali 542,113.00** pjesëmarrja në totalin e planifikimit të të hyrave për vitin fiskal 2025 do të jetë **47.80%**

Të hyrat nga Arsimi: Janë të hyra që vijnë kryesisht nga participimi i qytetarëve për shërbimet që kryhen në qerdhen e fëmijëve, si dhe të hyrat nga pagesat për arsimimin e përsheptuar ;

Të hyrat nga shëndetësia: janë ato të hyra që kanë të bëjnë me participimet në shëndetësi nga ana e qytetarëve.

1. Përcaktimi i prioriteteve

Është e qartë se një ndër segmentet më të rëndësishëm në procesin e hartimit të buxhetit është ai i përcaktimit të prioriteteve sidomos në pjesën e kategorisë së investimeve kapitale. Bazë e përcaktimit të prioriteteve janë nevojat e qytetarëve të komunës sonë për të ngritur mirëqenien e tyre. Mbi bazën e këtyre nevojave kryetari i Komunës së bashku me stafin e tij si dhe në konsultimin me qytetarët e në varësi me mjetet e disponueshme do të ketë përcaktuar prioritetet 2025-2027 e në fokus ato të vitit fiskal 2025.

2. Buxheti në funksion të përmbushjes së nevojave.

Organizata jonë buxhetore ka të identifikuar nevojat për zhvillim të gjithëmbarshtëm por që janë në disproporcion me mundësitë buxhetore. Edhe buxheti i vitit fiskal 2025 do të ndikoj në masë të konsideruar në zhvillimin e komunës sonë në të gjitha sferat por asesi nuk mundë të përmbushë kërkesat e përgjithëshme qytetare. Në këtë drejtim absorbimi i granteve të donatorëve qofshin ato të mbredshme apo të jashtme do të ndikoj pozitivisht në ngritjen e trendit në realizimin e kërkesave zhvillimore e sociale.

3. Buxheti në përkrahje të zhvillimit ekonomik

Vlera e limituar e buxhetit jep hapsirë dhe mundësi për një ndikim të theksuar në fushën e zhvillimit ekonomik të komunës sonë.

4. Identifikimi i nevojave

Zakonisht Kryetari i Komunës së bashku me stafin e tij në kuadër të procesit të hartimit të buxhetit duhet të organizoj dëgjime buxhetore me qytetarë. Për vitin 2025 janë mbajtur 25 dëgjime buxhetore. Janë bërë raport përmbledhës për nevojat dhe prioritetet e tyre, kemi propozimet e qytetarëve të marrë në mënyrë individuale dhe nga kryetaret e Këshillave Lokale, por në këtë vit kemi edhe buxhetimi me pjesë vit kemi edhe buxhetimi me pjesëmarrje ku janë përzgjedhë dy projekte në dy lokalitete të ndryshme/Kamenicë dhe Petrit.

Në këtë drejtim roli i qytetarëve është i pazëvendësueshëm, dhe lypset nga ata që përherë të jenë pjesë e vendim marrjes e sidomos në procesin e hartimit të projekt buxhetit, përmes të cilit ata do të mundë të realizojnë synimet, projektet e tyre në funksion të ngritjes së mirëqenies, Është për tu përmendur se nga shuma e planifikuar e Tatimit në Pronë prej 542,113.00 duhet të planifikohet buxheti për investime kapitale që mjetet e inkasuara tu kthehen qytetarëve me investime kapitale.

1.SHPËRNDARJA E BUXHETIT NË PROGRAME BUXHETORE

Në kapitullin II të këtij dokumenti do të paraqesim shpërndarjen e buxhetit për vitin 2025 në programet buxhetore, kategori dhe nënkategori buxhetore.

Shpërndarja buxhetore në kategori ekonomike gjithnjë është në varshmëri me përcaktimet apo limitet buxhetore të pranuar me qarkoren buxhetore 2025/02.

	2,023	2,024	2,025	2,026	2,027	Diferenca	Progresi	Progresi	Progresi
							1	2	3
							2025-2024	2026-2025	2027-2026
Numri I Punetoreve	1,172	1,140	1,154	1,154	1,154	14			
Grandi I pergjithshem	5,360,529.00	5,976,303.00	6,452,896.00	6,825,286.00	7,204,464.00	476,593.00	107.97	105.77	105.56
Grani I Arsimit	4,483,745.00	5,440,648.00	5,433,969.00	5,596,988.00	5,764,898.00	(6,679.00)	99.88	103.00	103.00
Grandi I shendetesise	1,397,854.00	1,892,973.00	2,041,687.00	2,138,871.00	2,240,681.00	148,714.00	107.86	104.76	104.76
Sherbimet sociale rezidenciale	183,000.00	197,272.00	220,000.00	200,000.00	200,000.00	22,728.00	111.52	90.91	100.00
Total Grandet	11,425,128.00	13,507,196.00	14,148,552.00	14,761,145.00	15,410,043.00	641,356.00	104.75	104.33	104.40
te hyrat vetanake	956,771.00	1,016,621.00	1,134,072.00	1,223,917.00	1,315,258.00	117,451.00	111.55	107.92	107.46
Totali	12,381,899.00	14,523,817.00	15,282,624.00	15,985,062.00	16,725,301.00	758,807.00	105.22	104.60	104.63
Paga dhe meditja	7,566,476.00	8,980,426.00	9,185,435.00	9,690,634.00	10,204,238.00	205,009.00	102.28	105.50	105.30
Mallra dhe sherbime	1,943,000.00	2,274,272.00	2,422,098.00	2,470,540.00	2,519,951.00	147,826.00	106.50	102.00	102.00
Shpenzime komunale	238,000.00	254,000.00	262,000.00	273,790.00	287,480.00	8,000.00	103.15	104.50	105.00
Subvencione	447,000.00	648,000.00	885,000.00	929,250.00	1,003,590.00	237,000.00	136.57	105.00	108.00
Investime Kapitale	2,187,423.00	2,367,119.00	2,528,091.00	2,620,848.00	2,710,045.00	160,972.00	106.80	103.67	103.40
TOTALI	12,381,899.00	14,523,817.00	15,282,624.00	15,985,062.00	16,725,304.00	758,807.00	105.22	104.60	104.63

Kodi i projektit	EMRI I PROJEKTIT	2024	2025	2026	2027
52633	Participimi me Donator	206,075.00			
	Ndertimi I salles sportit ne Kamenice		100,000.00		
	Ndertimi I rrjetit te ujesjellesit ne Kraqeve te Eperme		97,970.21		
	Zyra e Kryetarit	206,075.00	197,970.21		
54771	Ndertimi I hapesires ne shtepine e kultures "Isa Kastrati " dhe adaptimi I salles se kuvendit komunal ne Kamenice	70,000.00			
55069	Blerja e veturave per nevoja te Administrates Komunale	30,000.00			
55070	Digjitalizimi I arkivit ne Komunen e Kamenices	20,000.00			
55083	Ndertimi I objekteve administrative ne Komune te Kamenices	50,000.00			
	Administrata	170,000.00			
52689	Ndertimi I kanaleve te ujrave atmosferike ne Koretin,Rogane,L Qameri,Hodonoc,Muciverc	50,000.00	50,000.00	50,000.00	
53338	Ndertimi I Kanalizimit fekal ne Kamenice dhe fshatra Shipashnice,Karaqeve ,Busavate Kopernice,Koretin,Topanice	210,401.00	80,000.00		
53564	Ndertimi I sistemit te ujit automatike dhe parkut te qytetit	5,000.00			
54744	Ndertimi I deponive per mbeturina te ngurta ne Berivojce Topanic,Kolloleq e Novosell	30,000.00	30,000.00		
54760	Ndertimi rezervuarit te ujit te pijes ne Berivojce	60,000.00	20,000.00	10,000.00	
54783	Ndertimi I rezervuarit te ujit te pijes ne Kamenice		90,000.00	30,000.00	

54964	Blerja e mjeteve motorike mbi 1000 euro per administrate komunale	15,000.00	10,000.00		
55071	Ndertimi I sistemit te ujit te pijes ne fshatrat Muciverc ,Rogane,Novoselle,Hodonoc,Dajkoc,Hogosht dhe Shipashnice e Eperme	80,000.00	82,067.55		
55072	Ndertimi I pritoreve te autobusve ne Hogosht,Shipashnice e Poshtme,Hodonoc,Topanice,Koretin,Kopernice dhe Petrit	30,000.00	30,000.00	10,000.00	
55073	Zgjerimi I rrjetit te ndriqimit publik ne qytete dhe fshatra Karaqeve,Rogane,Kopernice,Koretin,Hogosht,Hodonoc,Strezoc,Krileve,Ajnoc,Berivojce,Topanice,Novoselle	20,000.00	40,000.00	70,000.00	
	Infrastruktura Publike	500,401.00	432,067.55	170,000.00	
52786	Ndertimi I tregut te gjelbert ne Kamenice		206,040.00	360,000.00	
52790	Ndertimi I hapësirave te reja per pikniqe dhe rekreacion Hodonoc,Hogosht,dhe Rogane Kamenice		60,000.00	50,000.00	
54787	Ndertim I tezgave per tregje mobile ne qytet dhe Rogane H.K	30,000.00	30,000.00		
55003	Ndertimi I objekteve te pashfrytezuara dhe komunale dhe adaptimi I tyre ne bujtina malore ne zonat rurale te Kamenices <Feriqeve,Poliqke,Tuxhec,Kranidell dhe Tersten	40,000.00	50,000.00	90,000.00	
	EKONOMIA	70,000.00	346,040.00	500,000.00	
52855	Ndertimi I Parqeve ne Kamenice,parku ne qendren e vjeter te qytetit ,parku te amfiteatri I bulevardit,parku mbrapa shtepise se kultures ne qytete dhe Petrit	40,000.00	24,000.00	50,000.00	
52880	Asfaltimi I rruges ne Shipashnice e Ulet rr.Pishat rr.Kranidell dhe RR Bahri Fazliu	18,200.00			
52900	Ndertimi I trotuarit ne rrugen kryesore ne Ruboc		80,000.00		
53021	Ndertimi I sistemit te ngrohjes qendrore ne sistem te decentralizuar ne Kamenice				

53441	Asfaltimi I rrugeve ne Dajkoc rrShaban Syl Krasniqi,Nebiu,Ali Zylfi Fazliu,Syle Rama Dajkoc,Xhafer e Nevzad Krasniqi	40,000.00	62,222.68		
53454	Ndertimi I Kuzhines Popullore ne Dajkoc,Kamenice	40,000.00			
54824	Asfaltimi I rrugeve ne Kamenice,(Ali Hadri,Dardaneve,Nuhi Berisha,Nexhemedin Kuqi,Shpend Dragobija,Sahit Baliq,Lam Breznica,Deg Shpend Dragobija dhe deg Besnik Maroca,Beteja e Ushit,Sef Koshara	80,000.00	184,111.00		
54829	Asfaltimi I rrugeve ne Hogosht	70,000.00	159,720.00		
54830	Asfaltimi I rrugeve ne Topanice	70,000.00	71,790.00		
54835	Asfaltimi I rrugeve ne Koretin	146,774.00	87,769.00		
54842	Asfaltimi I rrugeve ne Kopernice	50,000.00	22,665.00		
54845	Asfaltimi I rrugeve ne Karaqeve të Eperme	50,000.00	38,826.00		
54847	Asfaltimi I rrugeve ne Karaqeve e ulet	40,000.00	5,604.00		
54856	Asfaltimi I rrugeve ne Muciverc	40,000.00	39,911.00		
54874	Asfaltimi I rrugeve ne Rogane	80,000.00	66,119.00		
54875	Asfaltimi I rrugeve ne Berivojce	30,000.00	48,690.00		
54877	Asfaltimi I rrugeve ne Hodonoc	60,000.00	106,068.00		
54880	Asfaltimi I rrugeve lokale ne Petrit	30,000.00	25,283.00		
54883	Asfaltimi I rrugeve ne Shipashnice te Eperme	60,000.00	84,334.00		
54887	Asfaltimi I rrugeve ne Ruboc Hasan Prishtina	20,000.00	3,347.00		

55067	Asfaltimi I rrugëve ne fshatin Busavate rr Tema,rr Rama,Hasani,Hyda,Shahin Bejta ,Mehmet Rama deg	50,000.00	39,855.00		
55074	Ndertimi I urave te vogla nga betoni zgjerimi dhe riparimi I urave ekzistuese ne Rogane,Kamenice,Koretin,Berivojce,Krileve,Kopernice	30,000.00	11,210.00		
55076	Ndertimi I trotuerve ne Kamenice,dhe fshatrat Topanice,Kopernice,Karageve ,Shipashnice ,Rogane,Koretin	120,000.00	92,946.82		
55078	Ndertimi I urave metalike/beton per kembesor ne Koretin,Hajnoc,Berivojce,Karageve	30,000.00	63,596.00		
	PLANIFIKIMI URBAN DHE INSPEKSIONI	1,194,974.00	1,318,067.50		
55068	Renovimi I AMF-ve Busavate,Topanice,Karageve,Rogane,dhe Hogosht	20,000.00			
	ADMINISTRATA -SHENDETESI	20,000.00			
	Blerja e pajisjeve mbi 1000 euro ,Makine rrobash industriale		10,000.00		
	Autoambulnca		120,000.00		
	Ndërtimi i ashensorëve për personat me aftësi të kufizuara në QKMF dhe shtëpinë e kulturës		40,000.00		
	QKMF		170,000.00		
54902	Blerja e veturave zyrtare ne Sh.Rezidenciale	35,000.00			
	Blerja e pajisjeve mbi 1000 euro per komore,Frigorifer për ruajtje të ushqimit,pompë termike për nxemje,Tharëse rrobash industriale		35,000.00		
	SHERBIMET REZIDENCIALE KAMENICE	35,000.00	35,000.00		
53136	Ndertimi I shtigjeve te atletikes per klubin Atletik Rogana			200,000.00	
	SHERBIMET KULTURORE			- 200,000.00	

53258	Ndertimi I qerdhes ne Rogane		111,504.00	100,000.00	
55077	Renovimi I objekteve shkollore ne Kamenice dhe Rogane (Gjimnazet,Tekniket,sh.fillore dhe qerdhja ne Kamenice,Topanice dhe Karaqeve	103,895.00	32,085.00		
	Ndertimi I fushes se sportit ,kendi I lojrave dhe rrethoja e shkolles ne fshatin Petrit		40,000.00		
	ADMINISTRATA ARSIM	103,895.00	183,589.00	100,000.00	
54922	Ndertimi I tereneve sportive ne kuader te institucioneve arsimore ne Rogane ,Karaqeve,Kamenice,Petrit,Topanice	66,774.00	36,735.70		
	ARSIMI FILLOR I MESEM I ULET	66,774.00	36,735.70		
	TOTALI	2,367,119.00	2,719,469.96	770,000.00	-

KONKLUZIONET PËRMBYLLËSE :

- **Kemi një rritje te buxhetit në krahasim me vitin 2025 për 5.22% apo (758,807.00€)**
- **Kemi një Grand të përgjithëshëm të rritur me vitin 2025 për 7.97% apo (476,593.00)**
- **Kemi zvoglim me vitin 2025 të Grandit të Arsimit prej 0.12% apo në shumë prej ((-6,679.00)€**
- **Kemi një Grand i Shëndetësisë të rritur në krahasim me vitin 2024 për 7.86% apo 148,714.00€**
- **Ka një Grand të Shërbimeve Sociale rezidenciale të rritur në krahasim me vitin 2025 prej 11.52% apo 22,728.00€**
- **Kemi planifikim të të hyrave vetanake të rritur në krahasim me vitin 2025 për 11.55% apo 117,451.00€**
- **Ka një rritje në kategori për paga dhe mëditje krahasuar me vitin 2025 prej 2.28% apo (205,009.00€).**
- **Ka një rritje në kategori mallra dhe shërbime krahasuar me vitin 2024 prej 6.50% apo 147,826.00€.**
- **Ka një ritje në kategori shpenzime komunale krahasuar me vitin 2025 prej 3.15% apo 8,000.00€**
- **Ka një rritje në kategori të subvencioneve krahasuar me vitin 2024 prej 36.57% apo 237,000.00€.**
- **Ka një rritje në kategori Investime kapitale krahasuar me vitin 2024 prej 6.80% apo 160,972.00€.**